

KUJDES!

- Mos harroni të ngjyrosni grupin (A ose B) në fletë-përgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të ngjyroset me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta ngjyrosni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

Saktë ☐ A ☐ B ☒ C ☐ D



Gabim ☒ A ☐ B ☒ C ☐ D

- Bëni kujdes për të mos dalë jashtë rrethit kur të ngjyrosni përgjigjen.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si shkarravitje, rrudhosje etj.
- Mos iu përgjigjini pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 3 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **150 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan “PERGJIGJET”.
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Rezultati i provimit bazohet vetëm në fletë-përgjigje.
- Libërthi i pyetjeve dorëzohet bashkë me fletë-përgjigjen dhe nuk kërkohet marrja e tij.

Suksese!

1.

Mikeli bëri tre provime matematike dhe pikët mesatare të tyre janë 70. Cili nga sa vijon është një grafik i mundshëm i pikëve të Mikelit?




2.

Pesha mesatare e një grupi prej gjashtë personash është 60 kg. Nëse një person me peshë 80 kg largohet nga grupi, sa do të jetë pesha mesatare e pesë personave të mbetur?

- A) 56 kg
- B) 57 kg
- C) 58 kg
- D) 59 kg

3.

Në figurë, $m(\angle AOD) = 54^\circ$ dhe [OC përgjysmon $\angle DOB$. Gjej $m(\angle DOC)$.



- A) 56°
- B) 63°
- C) 70°
- D) 73°

4.

Cilat nga pohimet e mëposhtme janë të vërteta?

- I. Të gjithë numrat natyrorë të plotëpjesëtueshëm me 10 janë gjithashtu të plotëpjesëtueshëm me 5.
- II. Të gjithë numrat natyrorë të plotëpjesëtueshëm me 3 janë gjithashtu të plotëpjesëtueshëm me 6.
- III. Të gjithë numrat natyrorë të plotëpjesëtueshëm me 5 janë gjithashtu të plotëpjesëtueshëm me 2.
- IV. Të gjithë numrat natyrorë të plotëpjesëtueshëm me 9 janë gjithashtu të plotëpjesëtueshëm me 3.

- A) I, II dhe III
- B) I dhe IV
- C) II dhe III
- D) I, II, III dhe IV

5.

Sa më i madh është numri

$$5\frac{1}{6} \text{ se numri } 3\frac{2}{5}?$$

A) $\frac{23}{30}$

B) $\frac{13}{15}$

C) $1\frac{13}{15}$

D) $1\frac{23}{30}$

6.

Gjeni shumën e vlerave të numrit të plotë a në shprehje.

$$\frac{1}{18} < \frac{a}{54} < \frac{2}{9}$$

A) 60

B) 54

C) 50

D) 45

7.

Përmasat e dhomës janë 4 m me 6 m.

Nëse shkalla e zvogëlimit është 1:200, sa është sipërfaqja e dhomës në plan?

A) 4 cm^2

B) 5 cm^2

C) 6 cm^2

D) 12 cm^2

8.

15% e 120 është 20% e cilit numër?

A) 170

B) 140

C) 105

D) 90


9.

Nëse $x = -0.5$, cili nga pohimet është i saktë?

- A) $x < x^2$
- B) $x^2 < x^5$
- C) $\frac{1}{x^2} < \frac{1}{x}$
- D) $\frac{1}{x^4} < \frac{1}{x^5}$

10.

Në figurë, $AC \parallel DE$, $[DC]$ përgjysmon $\angle BDE$ dhe $m(\angle ACD) = 55^\circ$. Gjej $m(\angle ABD)$.



- A) 100°
- B) 110°
- C) 120°
- D) 130°

11.

Gjej vlerën e x .

$$1\frac{1}{2} \cdot \left(\frac{7}{8} + \frac{5}{9}\right) = 1\frac{1}{2} \cdot x + 1\frac{1}{2} \cdot \frac{5}{9}$$

- A) $\frac{5}{3}$
- B) $\frac{3}{2}$
- C) $\frac{7}{8}$
- D) $\frac{1}{4}$

12.

Gjej vlerën e $\frac{3}{0.5} - \frac{2}{0.25} + \frac{1}{0.125}$.

- A) 6
- B) 8
- C) 10
- D) 20

13.

Thjeshto shprehjen.

$$\frac{1}{3} \cdot (x+6) + \frac{5x}{3} - 2$$

- A) $2x - 2$
- B) $2x$
- C) $2x - 1$
- D) $2x + 1$

14.

Zgjidh ekuacionin

$$\frac{4x}{3} - 5 = x - \frac{17}{3}.$$

- A) - 3
- B) - 2
- C) 1
- D) 3

15.

Shuma e moshës së Anës dhe e babait të saj është 46. Tre vjet më parë, mosha e babait të Anës ishte shtatë herë më e madhe se ajo e Anës. Sa vjeç është Ana tani?

- A) 8
- B) 9
- C) 10
- D) 12

16.


Është dhënë $\frac{y}{x} = \frac{3}{5}$ dhe $x + y = 32$.

Gjej vlerën e $x - y$.

- A) - 8
- B) - 4
- C) 4
- D) 8

17.

Në figurën më poshtë, një gjashtëkëndësh i rregullt dhe një pesëkëndësh i rregullt kanë një kulm të përbashkët. Gjeni vlerën e këndit të treguar.



- A) 48°
- B) 50°
- C) 52°
- D) 54°


18.

Cili nga grupet e mëposhtme të të dhënave ka mesatare aritmetike 10 dhe amplitudë 35?

- A) 2, 34, 4, 3, 8
- B) 40, 8, 10, 2
- C) 5, 25, 35, 40, 50
- D) 4, 1, 2, 7, 36

19.

Gjeni ekuacionin e drejtëzës së paraqitur në rrjetin koordinativ më poshtë.



- A) $x + 3y = 3$
- B) $3x - y = 3$
- C) $x - 3y = -3$
- D) $x + 3y = -3$


20.

Çmimi i një telefoni është 90 dollarë + taksa 18%. Sa do të paguajë Kevin për këtë celular?

- A) \$105.4
- B) \$106.2
- C) \$108.3
- D) \$109.4

21.

Një katror gri është skicuar në një tabelë katrore të bardhë. Brinja e katrorit të bardhë është 4m dhe brinja e katrorit gri është 1m. Një fëmijë hedh një shigjetë në tabelë rastësisht.




Sa është probabiliteti që shigjeta të bjerë në zonën e bardhë, duke qenë se shigjeta e godet tabelën?

- A) $\frac{3}{4}$
- B) $\frac{13}{16}$
- C) $\frac{15}{16}$
- D) $\frac{7}{8}$

22.


Në figurë, O është qendra e rrethit, AOC është një trekëndësh kënddrejtë, $|AO| = 8$ cm dhe $|OC| = 10$ cm. Gjeni sipërfaqen e ngjyrosur. (Merr $\pi = 3$.)



- A) 80 cm^2
- B) 84 cm^2
- C) 88 cm^2
- D) 92 cm^2

23.

Në figurë, gjatësia e brinjës së kubit është 10 cm. Një cilindër me diametër 6 cm hiqet nga kubi. Gjeni vëllimin e trupit gjeometrik të mbetur. (Merr $\pi = 3$.)



10 cm

- A) 700 cm^3
- B) 710 cm^3
- C) 720 cm^3
- D) 730 cm^3

24.

Është dhënë se $\frac{1}{6^{-10}} = 6^{-x}$.

Gjej vlerën e x -it.

- A) -10
- B) -1
- C) 1
- D) 10


25.

Gjej vlerën e $20\sqrt{0} - 13\sqrt{1} + 7\sqrt{4}$.

- A) 1
- B) $\sqrt{2}$
- C) 2
- D) $2\sqrt{2}$

26.


Në figurë, ABC është një trekëndësh me $[AC] \perp [AB]$, $[AD] \perp [BC]$, $|AB| = 3 \text{ cm}$ dhe $|AC| = 4 \text{ cm}$. Gjeni lartësinë h . (Udhëzim: Përdorni sipërfaqen e trekëndëshit)



- A) 2 cm
- B) 2.2 cm
- C) 2.4 cm
- D) 2.6 cm

27.

Në figurë, $[AB] \perp [BC]$, $[AC] \perp [CD]$,
 $|AB| = 3 \text{ cm}$, $|BC| = 4 \text{ cm}$ dhe $|DC| = 12 \text{ cm}$.
 Gjej $|AD|$.



- A) 14 cm
- B) 13 cm
- C) 12 cm
- D) 11 cm

28.

Thjeshto shprehjen $\frac{\sqrt{5} + \sqrt{5} + \sqrt{5} + \sqrt{5}}{\sqrt{5} \cdot \sqrt{5} \cdot \sqrt{5}}$.

- A) 1
- B) $\frac{4}{5}$
- C) $\frac{3}{5}$
- D) $\frac{2}{5}$

29.

2, -5, -12, -19, -26, -33, -40 ...
 Cili është rregulli për vargun aritmetik të
 mësipërm?

- A) $15 + 7n$
- B) $8 - 4n$
- C) $7n - 23$
- D) $9 - 7n$

30.

Gjeni bashkësinë e vlerave të x -it
 që vërtetojnë mosbarazimin:
 $5 - 2x \leq 3x + 1 < 2x + 7$

- A) $x \leq 4$
- B) $-\frac{4}{5} \leq x < 6$
- C) $x \leq -\frac{4}{5}$ or $x < 6$
- D) $\frac{4}{5} \leq x < 6$

31.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?

5	4	7	5
1	7	5	8
1	8	5	7

 $\Rightarrow ?$

A) B)

$\Rightarrow = - \Rightarrow$	$\bigcirc - \triangle +$
$\Leftarrow = - \Rightarrow$	$\triangle + \Rightarrow \Leftarrow$
$- + - =$	$- \Rightarrow - \Rightarrow$

C) D)

$\bigcirc \triangle + \bigcirc$	$\triangle \nabla + \triangle$
$- + \bigcirc \Rightarrow$	$- + \triangle \Rightarrow$
$- \Leftarrow \bigcirc +$	$- \Rightarrow \triangle +$

32.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

INED
EMIK
ENIS $\Rightarrow$ KINE = ?
KINE

A) 2593 B) 5936
C) 3452 D) 3957

33.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

$$\frac{\square\square\square}{\square} + 55 = \bigcirc\square\square \Rightarrow \square\bigcirc = ?$$

A) 23 B) 46
C) 53 D) 61

34.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

$$\begin{array}{r} T \\ + \frac{N}{LL} \\ \hline \end{array} \begin{array}{r} LL \\ + \frac{LL}{MM} \\ \hline \end{array} \Rightarrow T+N+L+M = ?$$

A) 13 B) 14
C) 15 D) 16

35.

Cilat numra duhen në vend të pikëpyetjeve?

- I. $5 \bullet 4 = 81; 1$
- II. $4 \bullet 1 = 25; 27$
- III. $7 \bullet 5 = 144; 8$
- IV. $6 \bullet 2 = ?; ?$

- A) 64; 16
- B) 54; 4
- C) 56; 35
- D) 64; 64

36.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

- I. $4 \blacktriangle 4 = 8$
- II. $5 \blacktriangle 9 = 6$
- III. $10 \blacktriangle 22 = 8$
- IV. $3 \blacktriangle 9 = ?$

- A) 0
- B) 16
- C) 32
- D) 64

37.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

- I. $a \triangle b = 2a - 3b$
- II. $a \square b = ab + b^2$
- III. $a \bigcirc b = ab$
- III. $[(8 \triangle 5) \square 4] \bigcirc 2 = ?$

- A) 40
- B) 48
- C) 54
- D) 66

38.


Cili varg numrash duhet në vend të pikëpyetjes?

- I. 48, 54, 60, 66, 72, 78
- II. 32, 26, 20, 14, 8, 2
- III. 88, 80, 72, 64, 56, 48
- IV. ?

- A) 36, 40, 44, 48, 52, 56
- B) 16, 24, 32, 40, 48, 56
- C) 60, 52, 44, 36, 28, 20
- D) 6, 12, 18, 24, 30, 36

39.


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 0 B) 1
C) 4 D) 6

40.


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 37 B) 38
C) 39 D) 40

41.


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 3 B) 7
C) 9 D) 12

42.


Cilat numra duhen në vend të pikëpyetjeve?



- A) 36,240 B) 36,196
C) 12,228 D) 12,240

43.


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 6 B) 9
C) 12 D) 14

44.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



$$\Rightarrow K + L = ?$$

- A) 30 B) 31
C) 32 D) 33

45.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?


+	a	b	c
a		40	
b			34
c	22		

$$\Rightarrow \frac{a+b}{c} = ?$$

- A) 5 B) 9
C) 13 D) 16

46.


Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



- A)  B) 
C)  D) 


47.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?




48.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?




49.

Cila nga figurat është e ndryshme?



50.

Cilat numra duhen në vend të pikëpyetjeve?



- A) 10; 7; 1 B) 9; 7; 2
C) 8; 6; 2 D) 10; 7; 2

51.

Këngët e Eposit të kreshnikëve shoqërohen me:

- A) lirë
- B) lahutë
- C) kitarë
- D) thirrje drejtuar hyjnive

52.

Tiparet e përbashkëta të tregimit me përrallën, i gjejmë në pjesën:

- A) “Ajkuna qan Omerin”
- B) “Rozafati”
- C) “Rinë Katerinëza”
- D) “Kumbulla përtej murit”

53.

Ka shkruar “Novela të Qytetit të Veriut”:

- A) Ernest Koliqi
- B) Millosh Gjergj Nikolla
- C) Anton Pashku
- D) Martin Camaj

54.

Është mjeshtër i zbatimit të “teknikës së ajsbergut” në veprën e tij:

- A) Lë Klezio
- B) Gabriel Garsia Markez
- C) Ernest Heminguej
- D) Federiko Garcia Lorca

55.

Ka për qëllim të shprehë gjendje shpirtërore dhe emocione:

- A) teksti në prozë
- B) dramatika
- C) tragjedia
- D) teksti poetik

56.

Është një lirikë filozofike:

- A) “Bregu i mollës”
- B) “Kitara”
- C) “Bagëti e Bujqësi”
- D) “Gjeniu i anijes”

57.

Është shkruar nga Sofokliu:

- A) “Vdekja e Nositit”
- B) “Në mundsh”
- C) “Lule dielli”
- D) “Antigona”

58.

Është roman historik, që e merr temën nga ngjarje të vërteta historike:

- A) “Ngjarje pa lëvizje”
- B) “Kështjella”
- C) “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”
- D) “Plaku dhe deti”

59.

I përket llojit të komedisë:

- A) “Antigona”
- B) “Pas vdekjes”
- C) “Romeo dhe Zhulieta”
- D) “Gjashtë personazhe në kërkim të autorit”

60.

Kemi figurën e similitudës në vargjet:

- A) “Melankolia e përkund e këngë të ëmbla i këndon”
- B) “Dhambët e bardhë si gurëzit e lumit, fill pas shiut kur po i shndrit dielli ...”
- C) “Zogë, zogë kryezezë,/ ti e vetme, unë e vetme,/ mes shkretimit ti vajton,/unë këtu qaj ditë e natë ...”
- D) “Ti det, brohori fshehtësire!/Kuptim i pashtershëm, ti det!”

61.

Ka mbiemër të emëruar në fjalinë:

- A) Djali ishte i mençur si një burrë i vërtetë.
- B) Mençuria është jo vetëm dije, por edhe urtësi.
- C) Djali i vogël dukej më i mençur se të tjerët.
- D) Të mençurit hapin rrugë.

62.

Dalloni fjalinë që ka përemër të pacaktuar:

- A) Kush e ka qejf ëmbëlsirën me lajthi?
- B) A pyeti kush për mua sot?
- C) Le të afrohet këtu kush të dojë.
- D) Ai është nxënësi për të cilin të fola.

63.

Është në kohën e ardhme të përparme folja në fjalinë:

- A) Të jetë pranuar në universitet vallë?
- B) Do të ishte pranuar dhe ai këtë vit te ne.
- C) Po të kishte mësuar më shumë, do të kishte fituar një degë të mirë.
- D) Do të jem pranuar dhe unë bashkë me ju.

64.

Në cilën fjali, fjala e nënvizuar është parafjalë:

- A) Ti fole gjatë, veç unë nuk i kuptova ato që the.
- B) Veç kësaj, a ke gjë tjetër për të shtuar?
- C) Ikën bashkë, por u kthyen veç.
- D) Nuk mbetej veç ta merrje vetë nismën për ta filluar.

65.

Dalloni përdorimin e saktë të apostrofit:

- A) Ç'tu desh që të shkoje dhe ti me ta?
- B) M'a jep dhe mua librin që t'a lexoj dhe unë.
- C) I'a thashë të gjitha ç'ka kisha menduar.
- D) T'i tregova të gjitha për sa më pyete.

66.

Fjalët e shkruara saktë janë:

- A) ambjent, proçes, çertifikatë
- B) higjenë, standarte, bashkëautor
- C) gojëëmbël, zëëmbël, kokëulur
- D) higjienë, gojëmbël, ambient

67.

Fjala që ka kallëzues të thjeshtë foljor është:

- A) Do nderuar ky atdhe i shenjtë.
- B) Flamuri duhet të valëvitet i lirë në qiellin shqiptar.
- C) Ai ishte i lirë si zog në qiell.
- D) Flamuri ynë është valëvitur gjithmonë krenar në qiell.

68.

Ka mohim të pjesshëm në fjalinë:

- A) Po ma plotësove këtë dëshirë, je vërtet shportë magjike.
- B) Ajo s'ka frikë nga gjëra të tilla.
- C) Vajza bëri një hap prapa pa vetëdije.
- D) Ajo nuk e kishte parë kurrë të ëmën të trishtuar.

69.

Dalloni fjalinë dëshirore me folje në mënyrën lidhore:

- A) Ej, ta këndoja edhe njëherë atë këngë!
- B) Paskësh shkruar një vepër shumë të bukur!
- C) Mbretëroftë e mira në atdheun tonë!
- D) Qenkësh vërtet këngëtare e mrekullueshme ajo vajzë!

70.

Cila prej fjalive ka skemë të nënrenditjes paralele dhe e varguar:

- A) Kur po largoheshin, ai papritur u ndal, sepse duhej të përqafonte nënën.
- B) Pasi kuptoi se të gjithë kishin vëmendjen, heshti një çast që iu duk se zgjati një jetë.
- C) Të gjithë e donin atë, sepse ndihmonte këdo që kishte nevojë.
- D) Gjithë njerëzit e mirë ngjajnë bashkë, e kanë mirësinë në fytyrë dhe vështrimin e kanë të ngrohtë.